



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 2, pika 2.4.1; nenin 7, paragrafi 2 dhe nenin 8, paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Ligjit Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mbështetje të nenit 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit Shpronësues, miraton këtë :

V E N D I M

1. APROVOHET me vetiniciativë shpronësimi për interes publik i të drejtave private pronësore ose të drejtave tjera private në prona të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesëve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit **"Shtrimi - asfaltimi i rrugëve në fshatin Kmetoc, Komuna e Gjilanit"** Zona Kadastrale Kmetoc.
2. Shpronësimi të bëhet sipas Elaboratit të Shpronësimit duke u bazuar në gjendjen faktike në terren dhe matjeve të kryera gjeodezike në vendin e ngjarjes ku sipas këtij elaborati një pjesë e këtyre parcelave të përshkruara në regjistër kanë destinimin për rrugë në fshat.
3. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, konform nenit 22 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me Ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë -Sektori për çështje pronësoro juridike e Komunës së Gjilanit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga ana e Kryetarit të Komunës .

Gjilan, 02.06.2026

Alban HYSENI
Kryetar i Komunës